



KONTROLLI I LARTË I SHËTËTIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 04-228485

E-mail: rmuca@klsb.org.al; Web-site: www.klsb.org.al

Nr. 28/13 Prot.

Tiranë, më 31.07.2017

V E N D I M

Nr. 95, Datë 31.07.2017

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

"Efektiviteti i Politikave për Zhvillimin Strategjik të Turizmit"

Në zbatim të planit vjetor 2017, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI etj.), sipas shkresës Nr. 28, datë 06.01.2017, "Njoftim për fillim auditimi", ndërmoi auditimin me temë "Efektiviteti i Politikave për Zhvillimin Strategjik të Turizmit".

Ky auditim u programua për t'u ushtruar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, Agjencinë Kombëtare të Turizmit, Këshillin e Qarkut Berat, Këshillin e Qarkut Kukës dhe Këshillin e Qarkut Vlorë. Pas përfundimit të punës paraprake audituese u përgatit programi auditues me Nr. 28/1, datë 06.04.2017.

Nisur nga rëndësia ekonomike dhe sociale e këtij sektori, KLSH në zbatim të politikave të saj, të sanksionuara në Planin Strategjik, ligjin "Për funksionimin dhe organizimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ka marrë indicie dhe e ka parë si të rëndësishëm auditimin e kushteve dhe politikave për zhvillimin strategjik të turizmit.

Një vlerë e shtuar e këtij auditimi është bashkëpunimi me Zyrën Supreme të Auditimit të Kroacisë, në kuadër të projektit IPA për "Forcimin e Kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm në Shqipëri". Në auditim u përfshinë auditues Kroatë, të cilët ofruan ekspertizën dhe përvojën e tyre për formulimin e rekomandimeve sa më afatgjata dhe të orientuara drejt praktikave më të mira në rajon.

Në nivelin kombëtar në sektorin e turizmit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si institucioni kryesor përgjegjës për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, ka në varësi të saj dy agjenci:

- Agjencinë Kombëtare të Bregdetit e cila ka si mision të saj mbrojtjen dhe zhvillimin e zonës bregdetare,
- Agjencinë Kombëtare të Turizmit e cila ka si mision promovimin dhe krijimin e identitetit të turizmit shqiptar brenda dhe jashtë vendit.

Në nivelin rajonal zbatimi dhe koordinimi i politikave për turizmin realizohet nga njësitë e qeverisjes vendore, ku për nga lloji i turizmit që ofrojnë dhe numri i turistëve që i vizitojnë, grupi i auditimit përzgjedhi:

- Këshillin e Qarkut Berat, Këshillin e Qarkut Kukës dhe Këshillin e Qarkut Vlorë.
Efektiviteti i politikave për zhvillimin e turizmit në të gjitha nivelet e tij kërkon përmirësimin e disa komponentëve.

Së pari, duhet të hartohet dhe miratohet strategjia e zhvillimit kombëtar të turizmit, si kusht paraprak për realizimin e objektivave;

Së dyti, me miratimin e akteve normative që rregullojnë funksionimin e këtij sektori;

Së treti, krijimin e institucioneve me fushë zbatimi sektorin e turizmit, me qëllim zhvillimin e tij;
Së katërti, krijimin e data bazës me të dhënat statistikore reale, për përcatimin dhe orientimin e saktë të objektivave;
Së pesti, duhet të hartohen dhe miratohen zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.
Së gjashti, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të alokohen fonde për nivelin rajonal, kombëtar dhe lokal, sipas prioritetit të zbatimit të politikave në turizëm;
Së shtati, kategorizimin dhe standardizimin e strukturave akomoduese sipas kushteve të legjislacionit në fuqi.

Auditimi i jashtëm publik nëpërmjet KLSH, dhe për më tepër ai i performancës, është funksioni që lidh hallkat e ndryshme të aktiviteteve në institucione apo agjenci qeveritare, duke i orientuar ato drejt efektivitetit, eficiencës e ekonomicitetit dhe, në kuadër të këtij auditimi, nxitjen e përmirësimeve në politikat e zhvillimit strategjik të turizmit, për të ofruar një shërbim turistik sa më cilësor.

Në përfundim të punës audituese në terren, iu dërgua Projekt-raporti i Auditimit subjekteve të audituara:

MZHETTS, AKT dhe AKB me shkresën Nr. 28/10, datë 03.06.2017, Këshilli i Qarkut Berat me shkresën Nr. 28/7, datë 03.06.2017, Këshilli i Qarkut Kukës me shkresën Nr. 28/8 datë 03.06.2017, Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr. 28/9, datë 03.06.2017.

Pas respektimit të afatit për observacione nga palët e interesit, subjektet e audituara MZHETTS, AKT dhe AKB me shkresën Nr. 5386/5 prot., datë 05.07.2017, ardhur në KLSH me datë 05.07.2017 me nr. 28/11 prot., ka vlerësuar pozitivisht gjetjet dhe rekomandimet e trajtuara në Projektraport, të shoqëruara me disa vërejtje për çështje të veçanta. Më pas u procedua me hartimin e Raportit final të auditimit.

NJQV Berat, Kukës dhe Vlorë nuk kanë paraqitur observacione.

Më pas, është hartuar në afatën ligjor Raporti Përfundimtar i Auditimit, në të cilin janë pasqyruar gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të auditimit të KLSH-së.

Në përfundim, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna për subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, shkronja “c” të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”:

K O N K L U D O V A:

Ky sektor vuan nga një mungesë efijence dhe efektiviteti, sepse më parë dhe aktualisht, kanë munguar dhe vazhdojnë të mungojnë politikat e orientuara kah krijimit të produkteve turistike, strategjitë e bazuara në studime dhe plane veprimi të mirë detajuara, objektiva të qartë dhe të arritshëm për të siguruar zhvillimin ekonomik të pritshëm , marrë në konsideratë faktin se këto janë shoqëruar nga mosrealizimi i tyre në kohë dhe me cilësi. Pavarësisht përpjekjeve pozitive me projekte të ideuara nga AKB, sektori i turizmit ka një mungesë bashkëpunimi dhe komunikimi midis subjekteve në funksion të të cilave është përmirësimi i treguesve të turizmit si dhe historiku të zhvillimit në vite të shërbimit publik për turizmin.

Sektori i turizmit, së bashku me institucionet e varësisë përgjegjëse për turizmin, drejtohen në aktivitetin e tyre sipas Ligjit Nr. 93, datë 27.07.2015 “Për turizmin”. Ky sektor është një ndër furnizuesit kryesorë të ekonomisë me të ardhura të shprehur në termat e prurjeve valutore, rritjen e zërit të konsumit, përmirësimin e normave të punësimit si dhe nxitje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha, tërësia e të cilave ofron më shumë mirëqenie për popullsinë. Nëse i referohemi turizmit si koncept ekonomik, mund të ndikoj tek konsumatori në disa drejtime. Fillimisht në kostot e drejtpërdrejta që paguan në këmbim të shërbimit që merr, së dyti në kostot e tërthorta nga shpenzimet

e buxhetit të shtetit për këtë sektor, si dhe në mënyrën e ofrimit të këtij shërbimi me sa më shumë cilësi dhe standarde.

Në sfidat afatmesme dhe afatgjata të ekonomisë shqiptare turizmi vlerësohet një sektor me potencial për të arritur një rritje ekonomike më të lartë me efekte pozitive në rritjen e punësimit dhe të të ardhurave reale, rritjen e mirëqenies sociale, krijimin e një mjedisi mundësues për sipërmarrje të vogla dhe të mesme, nxitjen e interesit nga investitorët e huaj, i tillë që të ofrojë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social.

Duke parë ndikimin që ky sektor ka në zhvillimin ekonomik dhe të qëndrueshëm është mjaft e rëndësishme që shërbimi i turizmit të orientohet përgjatë një strategjie të analizuar, hartuar dhe detajuar me objektiva të arritshëm. Kjo strategji duhet të reflektojë dhe të orientohet kah zgjidhjes së problematikave në këtë sektor, të tillë që të përmirësojë të gjitha mangësitë e mëparshme dhe të krijojë baza për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, me qëllim përdorimin optimal të burimeve, minimizimin e ndikimeve negative ekologjike, kulturore dhe sociale si dhe maksimizimin e përfitimeve që vinë prej turizmit.

Deri në hyrjen në fuqi të Ligjit të ri Nr.93/2015 “Për Turizmin”, Ligji i mëparshëm Nr.9734 datë 14.05.2007 “Për Turizmin” vendosi rregullat mbi menaxhimin e sektorit të turizmit, zhvillimin e standardeve për shërbimet dhe produktet turistike. Që prej vitit 2007 e deri në vitin 2015, Ligji në fuqi për Turizmin nuk arriti të gjeneronte efekte të prekshme.

Ligji i ri Nr.93/2015 “Për Turizmin” nuk u plotësua me nxjerrjen në kohë të akteve ligjore dhe nënligjore, duke u shoqëruar kështu edhe me mos krijimin e disa Institucioneve kyçe që parashikohen në Ligj. Këto mangësi kanë zvogëluar kështu efektivitetin e institucioneve përgjegjëse për turizmin, duke vënë në dyshim funksionimin e tyre të plotë si dhe duke ndikuar negativisht në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit.

Megjithëse kanë kaluar 3 vjet nga hartimi i Draft-Strategjisë Kombëtare për Turizmin 2014-2020, sektori i turizmit nuk ka akoma një Strategji të Miratuar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të tij, por vetëm një draft-strategji për vitet 2017-2022, e cila është një studim i GIZ dhe jo një dokument i hartuar nga Ministria përgjegjëse për turizmin.

Aktualisht ka drejtime të rëndësishme që mbeten ende të porealizuara, të cilat lidhen me:

- Zhvillimin e qëndrueshëm të produktit dhe zbatimin e parimit të qëndrueshmërisë në të gjitha nivelet,
- forcimin e strukturave institucionale në nivel qendror dhe lokal, të cilat garantojnë zbatimin e planeve dhe objektivave strategjike,
- hartimin apo rishikimin e planeve urbanistike të zonave me prioritet turizmin mbështetur në analiza të plota ekonomike, sociale-kulturore, mjedisore,
- krijimi i një sistemi sipas standardeve ndërkombëtare për grumbullimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore mbi zhvillimin e kërkesës dhe ofertës,
- kategorizimin dhe standardizimin e strukturave akomoduese,
- zhvillimi i elementëve infrastrukturorë,
- arsimimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore në shërbim të turizmit,
- rritja e financimeve për mbrojtjen dhe rruajtjen e vendeve me rëndësi natyrore dhe kulturore,
- angazhimi i sektorit publik/privat,
- marketingu dhe promovimi i turizmit brenda dhe jashtë vendit,
- promovimi i praktikave më të mira,
- telekomunikacioni dhe interneti janë një komponent i rëndësishëm dhe domosdoshmërisht në rritje për promovimin e sektorit të turizmit dhe komunikimin.

Në lidhje me pyetjen kryesore të këtij auditimi,

“A sigurojnë institucionet përgjegjëse publike kushtet paraprake për zhvillimin strategjik të turizmit në vendin tonë?

u arrit në këtë mesazh:

Masat e marra nga qeveria dhe institucionet përgjegjëse për turizmin, mund të sigurojnë kushtet paraprake për zhvillimin e sektorit të turizmit në situatën në të cilën ndodhet, por nga ana tjetër ato

janë të pamjaftueshme për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të tij në periudhën afatgjatë. Sektori i turizmit, së bashku me institucionet përgjegjëse për turizmin, vuajnë nga një mungesë efiçense dhe efektiviteti. Mungesa e strategjive të bazuara në studime dhe plane veprimi, mungesa e nxjerrjes së akteve ligjore dhe nënligjore në kohë si dhe mungesa e krijimit të disa institucioneve të rëndësishme që parashikohen në Ligj, jo vetëm që e zvogëlojnë efektivitetin e institucioneve, por vënë në dyshim funksionimin e tyre të plotë si dhe ndikojnë negativisht në zhvillimin e turizmit. “Turizmi prioritet”, do të ishte më frytdhënës me legjislacion të kompletuar, punë konkrete, komunikim dhe bashkëpunim të ngushtë me sektorin publik dhe privat, me qëllim zhvillimin e këtij komponenti të rëndësishëm të ekonomisë sonë.

Nisur nga konkluzionet e mësipërme të veprimtarisë audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të sektorit të turizmit në Shqipëri:

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të “Efektiviteti i Politikave për Zhvillimin Strategjik të Turizmit”.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

Për pyetjen: A është plotësuar baza ligjore me aktet e parashikuara nënligjore dhe a është përmbushur në tërësinë e vetë kjo bazë ligjore?

Konkluzion:

Megjithëse Ligji Nr.9734, datë 14.5.2007 “Për Turizmin”, në fuqi prej vitit 2007 deri në momentin që doli Ligji Nr.93/2015, vendosi rregulla mbi menaxhimin e sektorit të turizmit, zhvillimin e standardeve për shërbimet dhe produktet e turizmit, ky Ligj nuk u zbatua në praktikë. Për një periudhë 8 vjeçare nuk u realizua procesi i standardizimit dhe kategorizimit të njësive akomoduese si dhe krijimi i produktit turistik.

Gjithashtu, mungesa e nxjerrjes së akteve ligjore dhe nënligjore në kohë lidhur me Ligjin aktual Nr.93/2015 “Për Turizmin” si dhe mungesa e krijimit të disa Institucioneve të rëndësishme që parashikohen në këtë Ligj, jo vetëm që e zvogëlojnë efektivitetin e institucioneve përgjegjëse për turizmin, por vënë në dyshim funksionimin e tyre të plotë si dhe ndikojnë negativisht në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit.

Disa nga çështjet kryesore në lidhje me mungesën e zbatimit dhe plotësinë e Ligjit Nr.93/2015 “Për Turizmin”:

1. Mungesa e nxjerrjes së akteve ligjore dhe nënligjore (VKM, urdhër, udhëzim, për të cilat është përgjegjës MZHETTS) në kohë;
2. Mungesa e krijimit dhe funksionimit që në fillim të vitit 2016, të Komisionit për Standartizimin e Veprimtarive Turistike me objektiv standartizimin kryesisht të njësive akomoduese;
3. Mungesa e krijimit të Degëve Territoriale të Shërbimit të turizmit që ka si objektiv kryesor koordinimin e punës në terren për zbatimin politikave të zhvillimit të produktit turistik;
4. Mungesa e Inspektoriatit që mbulon fushën e turizmit, i cili ka si qëllim të sigurojë zbatimin e legjislacionit të turizmit nga subjektet mbi të cilat vepron ky ligj, në përputhje me procedurat e kryerjes së inspektimit;
5. Mungesa e Komiteteve Rajonale për Zhvillimin e Turizmit me qëllim bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve të qeverisjes qendrore dhe njësive të qeverisjes vendore për çështjet e turizmit;
6. Mungesa e rregulloreve që kanë të bëjnë me Ligjin.

Konkluzione për aktet ligjore dhe nën ligjore:

- Nxjerrja me vonesë nga MZHETTS të Urdhërit “Për miratimin e rregullores për mënyrën e

organizimit, funksionimit dhe përbërjen e komisionit të standartizimit të veprimtarive turistike”, ka sjellë mungesën e ngritjes dhe funksionimit të kësaj strukture dhe mungesën e standartizimit të veprimtarive turistike (shërbimeve të ofruara nga hotelet, restorantet dhe të gjitha ato subjekte të cilat ofrojnë shërbime turistike), duke rritur mundësinë për uljen e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga hotelet, restorantet, etj.

- Nxjerrja me vonesë e Udhëzimit “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit”, ka sjellë mos krijimin në kohë të kësaj strukture, duke ndikuar negativisht në bashkëpunimin midis Institucioneve Qendrore përgjegjëse për turizmin dhe Institucioneve Vendore.
- Kanë munguar kriteret dhe kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së Agjencisë së Udhëtimit dhe Operatorëve Turistik për vitet 2012-2015, duke krijuar mundësinë që shumë individë të pajisen me licensë për ushtrimin e këtij aktiviteti, në mënyrë të pa drejtë, çka sjell informalitetin në këtë treg.
- Mungesa e klasifikimit të strukturave akomoduese sipas VKM Nr.730, datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, përkatëse, sjell që këto struktura të cilat ofrojnë shërbimin e akomodimit të klasifikohen jo në mënyrë ligjore, duke rritur informalitetin, mundësinë për uljen e cilësisë së shërbimit të ofruar dhe në përcaktimin e saktë të objektivave në strategjinë për zhvillimin e turizmit 2014-2020.

Konkluzione për Institucionet:

- Mungesa e Inspektoriatit në fushën e turizmit si dhe nisur nga rëndësia e funksioneve të tij për turizmin, mund të sjellë rritjen e numrit të shkeljeve nga subjektet private si dhe mosrrespektimin e kriterëve dhe kushteve të vendosura në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.93/2015 “Për Turizmin”.
- Mungesa e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit ka ndikuar negativisht në koordinimin e punës në terren për zbatimin e politikave për zhvillimin e produktit turistik, ka sjellë mungesën e bashkëpunimit të Institucioneve përgjegjëse për turizmin me sipërmarrjet private.
- Mungesa e sektorit të riskut për AKT dhe AKB sjell mungesën e krijimit të saktë të regjistrit të riskut në të cilin pasqyrohen të gjitha risqet që pengojnë Institucionin në realizimin e objektivave.
- Funksionimi i AKT dhe AKB me rregullore të vjetër, e cila nuk pasqyron ndryshimet në strukturë, mund të krijojë përsëritje të përgjegjësive dhe funksioneve.

Konkluzion:

- Deri në vitin 2015 nuk ka patur një bazë të dhënash me burimet turistike që ndodhen në vendin tonë, e cila rrjedhimisht ka ndikuar negativisht dhe në përcaktimin e saktë të objektivave në draft-strategjinë për zhvillimin turizmit 2014-2020 dhe krijimin e produktit turistik.

Për këtë rekomandojmë:

1. MZHETTS të marrë masa për krijimin e këtij Inspektoriatit në fushën e turizmit.

Menjëherë

2. MZHETTS të marrë masa për krijimin e Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit.

Menjëherë

3. Deri në momentin e krijimit të Degëve Territoriale të Shërbimit të Turizmit, me qëllim krijimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave për strukturat akomoduese, agjencit, operatorët turistik, DPPT të kryejë detyrat që i ngarkohen sipas Urdhërit Nr.8657, datë 28.10.2016.

Deri në momentin e krijimit të Degëve

4. MZHETTS të filloj të kryejë standartizimin e veprimtarive turistike, duke sjellë në këtë mënyrë dhe një përcaktim më të saktë të objektivave për standartizimin e veprimtarive turistike në strategjinë që do të miratohet për zhvillimin e turizmit 2017-2022.

Menjëherë

5. MZHETTS të marrë masat e nevojshme për krijimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit.

Menjëherë

6. Bazuar në Ligjin 115/2015 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Drejtori i Përgjithshëm i AKT dhe AKB, të marrë masat për krijimin e sektorit të menaxhimit të riskut si dhe hartimin e regjistrit të riskut.

Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2017

7. AKT dhe AKB të marrë masat e nevojshme për miratimin e rregullores e cila do të reflektojë ndryshimet e kryera në strukturën e saj.

Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2017

Për pyetjen: A ka programe strategjike të miratuara për zhvillimin e turizmit?

Gjatë 20 viteve të fundit, zhvillimi i turizmit nuk i është përgjigjur pritshmërive të popullit shqiptar përsa i takon përdorimit të potencialeve të vendit dhe, çka është më e rëndësishme, zhvillimit jo të qëndrueshëm të këtij sektori. Ndër vite, shumë probleme janë diskutuar me publikun e gjerë pa iu dhënë zgjidhja e duhur planifikimit të turizmit, mungesës së kapaciteteve, problemeve lidhur me shërbimet, mungesave në infrastrukturë, mungesës së bashkërendimit mes nivelit qendror dhe pushtetit lokal, investimeve të pabashkërenduara të subjekteve privatë, rolit të munguar të Ministrisë etj.

Në vitin 2006 u përgatit nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me PNUD Shqipëri, Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit Kulturor 2006. Strategjia kishte një plan masash konkrete për përmirësimin e destinacioneve të turizmit kulturor dhe rritjen e promovimit dhe marketingut të këtij segmenti turizmi. Për të shpjeguar strategjinë dhe nxitur sinergjinë për zbatimin e saj, u ndërmor një tur takimesh në 12 qarqet e vendit me njësitë e pushtetit vendor, shoqërinë civile rajonale dhe mediat. Strategjia gjeti mirëkuptim dhe përcolli shumë ide e sugjerime nga ana e veprimtarëve turistikë lokale dhe nga shoqëria civile, por u zbatua pjesërisht, për shkak të mos vazhdimit të implementimit të saj në vitet në vijim.

Në vitin 2014, kur u hartua Draft-Strategjia për Zhvillimin e Turizmit, e cila mbeti vetëm në versionin draft, Shqipëria prezantonte një vend me potenciale, të cilat mund të përdroreshin në interes të zhvillimit. Draft-Strategjia u dizajnuar për rritjen dhe forcimin e sektorit, me fokus të veçantë në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe identifikimin e sfidave për të maksimizuar kontributin në sektor. Draft-Strategjia Kombëtare për Turizmin 2014-2020 është një dokument i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në Shqipëri në vitet e ardhshme, si platforma kryesore e lidhur me politikën, reformat dhe masat në sektorin e turizmit jo vetëm për Qeverinë dhe Ministrinë përgjegjëse për turizmin, por dhe për palët e tjera të interesuara të përfshira, si: pushteti lokal dhe sektori privat. Ky draft pasqyron kërkesën e gjithë palëve të interesuara për pritshmëri të larta lidhur me kontributet e turizmit dhe nevojën për rolin drejtues të Ministrisë përgjegjëse për turizmin. Hartimi i këtij drafti u mbështet nga Qeveria Gjermane nëpërmjet programeve të bashkëpunimit teknik të GIZ, Mbështetja e Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit (EDEP) dhe Mbrojtja e Agro Biodiversitetit në Zonat rurale të Shqipërisë (CABRA).

Konkluzion:

- Megjithatë kanë kaluar 3 vjet nga hartimi i Draft-Strategjisë Kombëtare për Turizmin 2014-2020, sektori i turizmit nuk ka akoma një Strategji të Miratuar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të tij, por vetëm një draft-strategji për vitet 2017-2022, me të dhëna statistikore që nuk pasqyrojnë saktësisht realitetin, me objektiva që janë të vështirë për t'u arritur, i cili është një studim i GIZ dhe jo një dokument i hartuar nga MZHETTS dhe DPZHT.

Për këtë rekomandojmë:

1. MZHETTS të marri masat e nevojshme për miratimin e strategjisë si një nga objektivat kryesorë të vendosur në SKZHI për vitet 2015-2020, gjithashtu kjo strategji të shoqërohet me studime të detajuara, të mbështetet në të dhëna statistikore reale, të vendosen objektiva të arritshëm dhe të bëhet kostimi i saj.

Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2017

Për pyetjen: A është e përshtatshme baza e të dhënave statistikore për gjenerimin e objektivave?

Konkluzione:

- Mungesa e një procedure specifike dhe të miratuar për informacionin statistikor në sektorin e turizmit, krijon pasaktësi në këtë informacion, duke ndikuar negativisht në përcaktimin e objektivave për strategjinë e zhvillimit të turizmit.
- Mungesa e të dhënave për vitin 2016, por dhe mangësitat në indikatorët e përdorur në sektorin e turizmit, sjellin efekte negative në objektivat që do të vendosen në strategjinë për zhvillimin e turizmit dhe tregojnë se nuk ka qenë objekt analize nga MZHETTS zhvillimi i këtij sektori nëpërmjet arritjes së objektivave dhe evidentimit të përgjegjësive.
- Nxjerrja e Urdhërit Nr.8707, datë 31.10.2016 “Për miratimin e formatit për mbledhjen e të dhënave statistikore nga agjencitë e udhëtimit, operatorët turistikë dhe strukturave akomoduese” me vonesë, ka sjellë mungesën e një procedurë për mbledhjen e të dhënave, mungesën e raportimit që duhet të kryejnë çdo muaj agjencitë dhe operatorët turistikë dhe rrjedhimisht në mungesën dhe përditësimin e të dhënave statistikore në sektorin e turizmit.
- Zyra e statistikave në MZHETTS nuk ka kryer përditësim të plotë të dhënave mbi numrin e agjencive dhe operatorëve turistikë, duke ndikuar negativisht në objektivat e vendosura në Draft-Strategjinë 2017-2022 mbi agjencitë dhe operatorët turistikë.
- Mungesa e një metodologjie për mbledhjen e informacionit statistikor, mund të krijojë pasaktësi si dhe rrit numrin e gabimeve në mbledhjen e informacionit.

Për këtë rekomandojmë:

1. Sipas gjyqimit të grupit të auditimit, DPZHT duhet të hartojë një procedurë për informacionin statistikor në sektorin e turizmit.

Menjëherë

2. MZHETTS të propozojë në Ligjin 93/2015 “Për Turizmin” dhe në strategjinë që do të hartohet për zhvillimin e turizmit, zbatimin dhe implementimin e Llogarisë Satelitore të Turizmit (TSA), si një praktikë ndërkombëtare, me qëllim fuqizimin e statistikave në turizëm.

Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2017

3. Krijimi i zyrave turistike në çdo qytet si dhe të krijohet në këto zyra një Sistem Menaxhimi Informacioni me qëllim identifikimin dhe mbledhjen e të dhënave ekzistuese mbi çfarë ofron zona, strukturimin e bazës së të dhënave, specifikimin e itinerareve në broshura, shoqëruar me fotografi, profilin e produktit, si dhe duke vendosur, sinjalet nacionale, simbolet dhe logot sipas produktit lokal.

Menjëherë

4. DPZHT të shtojë dhe të përditësojë informacionin referuar indikatorëve të përdorur në sektorin e turizmit, tu referohet praktikave më të mira të vendeve të rajonit, si Kroacia, etj.

Vazhdimisht

5. Format i mbledhjes së të dhënave i përcaktuar në Urdhërin Nr.8707, datë 31.10.2016 “Për miratimin e formatit për mbledhjen e të dhënave statistikore nga agjencitë e udhëtimit, operatorët turistikë dhe strukturave akomoduese” t’u vihet menjëherë në dispozicion agjencive dhe

operatorëve turistik, me qëllim grumbullimin dhe përpunimin e saktë të informacionit statistikor për sektorin e turizmit.

Menjëherë

6. Zyra e statistikave në MZHETTS, e cila është përgjegjëse për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore, të kryejë përditësimin e saktë dhe të plotë të numrit të agjencive dhe operatorëve turistik.

Menjëherë

7. Këshilli i Qarkut Vlorë, Berat dhe Kukës si dhe njësit administrative të cilat përfshihen në këto Qarqe të hartojnë një metodologji për përgatitjen e databazës me informacionin statistikor, i cili raportohet në MZHETTS.

Menjëherë

8. Këshilli i Qarkut Berat së bashku me njësit administrative të përfshira në këtë Qark të respektojnë frekuencën e raportimit përcaktuar në nenin 19, pika b të Ligjit 93/2015 “Për Turizmin” si dhe të krijohet një faqe interneti, në të cilën të jepet informacion i detajuar se çfarë turizmi ofrohet në këtë zonë.

Vazhdimisht

Për pyetjen: A ka studime tregu mbi të cilat hartohen planet strategjike për zhvillimin e turizmit?

Konkluzion:

- Mungesa e studimeve të hartura qartë dhe saktë me të gjithë faktorët që kanë ndikim në zhvillimin e një produkti turistik, mungesa e sinjalistikës së nevojshme për informimin e turistit, sjell efekte negative në planifikimin e masave dhe veprimeve për zhvillimin e turizmit.

Për këtë rekomandojmë:

1. DPZHT të kryejë studime të sakta dhe të parashikojë të gjitha ndikimet ekonomike, sociale, ekologjike që mund të sjell zhvillimi i një produkti të caktuar turistik, me qëllim marrjen e masave të duhura dhe vendosjen e objektivave të arritshëm.

Vazhdimisht

2. Specialisti përgjegjës për menaxhimin e informacionit të pasqyruar në faqen e internetit të kryejë përditësimin e informacionit si dhe vendosjen e saktë të tij.

Vazhdimisht

3. Këshilli i Qarkut Vlorë dhe Berat në projektet e ardhshme që do të realizojnë për zhvillimin e turizmit, të kryejë paraprakisht studime të detajuara për të gjithë elementët që ndikojnë këto projekte, me qëllim përcaktimin e saktë të nevojës për fonde, për realizimin në kohë dhe me cilësi të këtyre projekteve.

Vazhdimisht

4. Këshilli i Qarkut të Beratit së bashku me njësit administrative të tij, të pajisin me sinjalistikën e nevojshme burimet e tyre turistike, të ngrihet në çdo njësi administrative zyrë informacioni për turistin, me qëllim informimin e tij dhe në një mënyrë promovimin e llojeve të ndryshme të turizmit që ofron ky Qark.

Menjëherë

Për pyetjen: A ka qenë efektiv procesi i kategorizimit të njësive akomoduese?

Proçesi i kategorizimit dhe i klasifikimit të njësive akomoduese i shënoi fillimet e tij me Ligjin Nr.9734, datë 14.05.2007 “Për Turizmin”, me daljen e VKM Nr.601 datë 12.09.2007 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, në të cilën përcaktoheshin kriteret për kategorizimin dhe klasifikimin e njësive akomoduese dhe rezultoi jo efektiv, pasi deri në momentin e daljes së Ligjit të ri të turizmit nuk u zbatua. Aktualisht me miratimin e Ligjit Nr.93, datë 27.07.2015 “Për Turizmin”, i cili ka si objekt rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private, që ushtrojnë veprimtari turistike dhe përcaktimi i të drejtave e detyrimeve të subjekteve pjesëmarrëse në këto veprimtari, në përputhje me standardet e përcaktuara në këtë Ligj, proçesi i kategorizimit të njësive akomoduese nuk ka filluar akoma, gjithashtu aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë proçes të cilat dolën një vit me vones, rezultojnë të kenë mangësira në përmbajtjen e tyre dhe të krijojnë kushte të pa drejta për njësitë akomoduese që operojnë në sektorin e turizmit.

Konkluzione:

- Nga intervista realizuar me Drejtorin e DPZHT, rezultoi se proçesi i kategorizimit nuk ka filluar akoma të zbatohet.
- Në VKM Nr.730 datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, nuk parashikohen në procesin e klasifikimit edhe shtëpit private (apartamentet), të cilat ofrojnë akomodim për turistët.
- Faqja zyrtare në internet ku mund të aplikohet online për pajisjen me certifikatën e klasifikimit nuk është akoma në funksion.

Për këtë rekomandojmë:

1. MZHETTS së bashku me strukturat përkatëse të marri masat e nevojshme për të filluar procesin e kategorizimit.

Menjëherë

2. Duke qenë se MZHETTS së bashku me strukturat e varësis së saj, të cilat janë përgjegjëse për hartimin e kësaj rregulloreje, të parashikojnë në procesin e klasifikimit edhe shtëpit private (apartamentet) sipas “EU Regulations” për turizmin, ku klasifikohen edhe apartamentet private si njësi akomoduese.

Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2017

3. Faqja zyrtare në internet, e cila shërben për aplikimin për pajisjen me certifikatën e klasifikimit të vihet në funksion.

Menjëherë

Për pyetjen: A janë të mirëpërcaktuara strukturat organizative në të gjitha nivelet (kombëtar, rajonal dhe lokal) të njësive përgjegjëse për të siguruar zhvillimin e turizmit?

- Sipas Ligjit Nr.93/2015 “Për Turizmin” dhe akteve ligjore dhe nënligjore për krijimin dhe funksionimin e strukturave në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor, rezulton se strukturat si KKSPT, Inspektoriat dhe KSVT të cilat janë krijuar, por që nuk kanë nisur ende të ushtrojnë detyrat dhe funksionet, me qëllim përmbushjen e objektivave të tyre përkatëse. Nga ana tjetër, zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit, ngelet thjesht një objektiv në letër, për arsye se institucionet të cilat bashkërendojnë veprimtarinë për turizmin në nivel rajonal dhe lokal, ende nuk janë krijuar.

Për pyetjen: A ushtrojnë institucionet detyra të nevojshme për zhvillimin e turizmit përfshirë programet e promovimit që synojnë zhvillimin strategjik të turizmit?

- Mos përmbushja e detyrave të nevojshme dhe funksioneve sipas akteve rregullative në fuqi të MZHETTS dhe DPZHT, zvogëlon performancën e strukturave përgjegjëse për turizmin çka sjell

tkurrije të zhvillimin strategjik të sektorit të turizmit.

- Mungesa e programeve të detajuara të promovimit të turizmit shqiptarë si një destinacion turistik, si dhe planeve marketing afatshkurtra dhe afatmesme, të shoqëruara me aktivitete dhe struktura përgjegjëse për ndjekjen e tyre, krijon problematika në evidentimin e sektorit të turizmit si prioritar në zhvillimin strategjik të vendit dhe përmbushjen apo përmirësimin e treguesve financiar që ky sektor gjeneron.
- Mungesa e hartës së miratuar për zonat me përparësi zhvillimin e turizmit ka sjellë mos investime infrastrukturore në këto zona, duke mos ofruar produkte turistike.

Për këtë rekomandojmë:

1. MZHETTS të marrë masa të menjëhershme për të hartuar dhe miratuar programe të detajuara dhe plane zbatimi për promovimin e sipërmarrjeve vendase dhe të huaja midis sektorit publik dhe privat në kuadër të thithjes dhe zhvillimit të investimeve në fushën e turizmit

Menjëherë

2. MZHETTS në bashkëpunim me ministritë e linjës institucionet e varësisë dhe njësitë e qeverisjes vendore, të marrë masa të menjëhershme për të hartuar programe të detajuara promovimi, sipas nivelit rajonal, kombëtar dhe lokal, të shoqëruara me detyra specifike për secilin institucion dhe indikatorë të përmbushjes së objektivave strategjik të promovimit dhe përmirësimin të cilësisë në fushën e turizmit.

Menjëherë

3. MZHETTS të marrë masa për të rritur numrin e marrëveshjeve reciproke dypalëshe midis vendeve të zhvilluara të rajonit dhe me gjerë, në sektorin e turizmit, duke specifikuar kriteret dhe strukturat ndjekëse të termave të marrëveshjeve.

Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2017

4. MZHETTS në bashkëpunim me ministritë e linjës, të marrë masa të menjëhershme, për të hartuar dhe miratuar zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

Menjëherë

5. MZHETTS në bashkëpunim me institucionet e varësisë, të marrë masa të menjëhershme, për të hartuar dhe miratuar Strategjinë Kombëtare të Marketingut shoqëruar me studime, plane veprimi dhe plane zhvillimi marketing.

Menjëherë

- Pavarësisht se AKT ka marrë pjesë në disa panairë ndërkombëtare dhe ka krijuar markën e cilësisë (logo+brand) për produktet dhe shërbimet turistike në vend, kjo nuk do të thotë se përgjegjësia e promovimit të Shqipërisë si destinacion turistik finalizohet me kaq. Mungesa e programeve të detajuara dhe të shoqëruara me anekse shpjeguese mbi promovimin, sjellë performancë të ulët të AKT-ës në përmbushjen e objektivave institucional.

Për këtë rekomandojmë:

1. AKT të marrë masa të menjëhershme në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse të turizmit, institucionet vendore, ekspertët dhe aktorë të tjerë vendas dhe ndërkombëtarë, për të hartuar programe promovimi të detajuara dhe shoqëruara me studime për secilin indikator.

Menjëherë

2. AKT të marrë masa për hartimin dhe detajimin e pjesmarrjes në panairë ndërkombëtare, duke raportuar efektin e pritshëm në indikatorët e turizmit.

Menjëherë

3. AKT të bëhet pjesë aktive në evidentimin e problematikave që lidhen me hartimin e strategjisë së zhvillimit të turizmit.

Menjëherë dhe vijimësi

- Edhe pse AKB zbaton me përpikmëri procesin e monitorimit të subjekteve dhe veprimtarisë së tyre përgjatë zonës bregdetare, përmbushja e përgjegjësive dhe detyrave institucionale është e vështirë të realizohet, duke qene se nuk ka në përdorim rregullore të brendshme të miratuar me funksione sipas strukturës.

Për këtë rekomandojmë:

1. AKB të marrë të menjëhershme, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse të turizmit, institucionet e qeverisjes vendore dhe ekspertët për të hartuar programe mbi menaxhimin e integruar të bregdetit.

Menjëherë

2. AKB të marrë masa për hartimin e planeve të veprimit mbi menaxhimin e integruar të bregdetit.

Menjëherë

3. AKB të marrë masa për hartimin e planeve dhe formës së monitorimit ekonomik të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë përgjatë zonës bregdetare.

Menjëherë

- Detyrat dhe përgjegjësitë e NJQV në lidhje me turizmin, nuk derivojnë nga plane, objektiva apo programe promovimi të institucioneve qendrore si MZHE'TTS, e cila ka sjellë mos targetim të turizmit si sektor prioritar për zhvillim strategjik gjatë periudhës objekt auditimi.

Për këtë rekomandojmë:

1. NJQV të marrë masa për hartimin e programe të promovimit dhe diversifikimi të destinacioneve turistike në produkte turistike, në funksion të zbatimit të objektivave kombëtarë të promovimit në turizëm miratuar nga MZHE'TTS dhe akteve rregullative në fuqi.

Menjëherë dhe vijimësi

Për pyetjen: A ka ndonjë bashkëpunim dhe komunikim të ndërsjelltë midis strukturave përgjegjëse për zhvillimin e turizmit në të gjitha nivelet?

- Që procesi i punës, ndarë sipas përgjegjësive të secilit institucion në përmbushje të funksionit për turizmin të funksionoj, duhet të jetë i lidhur me të gjitha strukturat e qendrës, institucionet e varësisë, degët rajonale të tyre dhe NJQV, duke operuar si një i tërë në realizimin e objektivave strategjike.
- Dy agjencitë kryesore në fushën e turizmit, nuk mund të funksionojnë të ndara, pa përgjegjësinë e Ministrisë përgjegjëse për turizmin në krye të vendimmarrjes së tyre, referuar juridiksionit të varësisë që ato kanë.

Për këtë rekomandojmë:

1. MZHE'TTS me praninë e ministrit ose anëtari tjetër të stafit, të jetë pjesë e strukturave drejtuese vendimmarrëse të AKT dhe AKB, për të ndjekur vazhdimësinë e komunikimit dhe realizimin e misionit të tyre institucional.

Për pyetjen: A ka burime të mjaftueshme (punonjës me njohuri dhe eksperiencë, fonde etj) për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësiive institucionale? A përdoret taksa e fjetjes në hotel për zhvillimin e turizmit? A ekzistojnë risqe operationale që vështirësojnë arritjen e objektivave në zhvillimin e turizmit?

- Në institucionet përgjegjëse të turizmit, shpërndarja e stafit sipas strukturave, nuk është kryer bazuar në formimin dhe eksperiencën e lidhur me fushën e turizmit. Kjo ka sjellë mbivendosje të detyrave dhe përgjegjësiive të stafit dhe njëherësh neglizhim të rëndësishëm të trajtimit të sektorit të turizmit në DPZHT dhe NJQV.
- Mungesa e procedurave të miratuara mbi kriteret e aplikimit, përzgjedhjes së fituesve, formës dhe standarteve të raportimit financiar dhe narrativ të projekteve në ndihmë të zhvillimit të turizmit, ka sjelle parregullsi në shpërndarjen e tyre sipas prioriteteve strategjike të promovimit dhe zhvillimit të produktit duke rezultuar në një proces joefektiv.

Për këtë rekomandojmë:

1. MZHETTS në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të autorizoj fonde për nivelin rajonal, kombëtar dhe lokal, sipas prioritetit të zbatimit të politikave në turizëm si dhe të veçoj në mënyrë eksplicite pozicionin dhe funksionin e specialistit të turizmit nga ai i specialistit të arsimit, turizmit, punësimit dhe kulturës, siç aktualisht funksionon.

Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2017

2. Në MZHETTS, AKT dhe AKB të rekrutohen personel sipas formimit për fushën e turizmit dhe kriterëve specifike të njohurive dhe eksperiencës në këtë sektor.

Vazhdimisht

3. MZHETTS në bashkëpunim me Bankat dhe sistemin financiar, të hartojnë programe mbështetjeje financiare për sektorin e turizmit dhe programe promovimi për organizimin e konferencave ndërkombëtare të turizmit.

Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2017

4. MZHETTS të miratojë manualin e përcaktimit të kushteve, kriterëve, tarifave, afateve dhe procedurës për klasifikimin e strukturave akomoduese, të jepet informacion shpjegues për metodologjin e llogaritjes së kostove të mësipërme, si dhe tarifat për strukturë të përcaktohen në mënyrë të drejtë duke mos cënuar parimet e konkurrencës së ndershme për njësit akomoduese.

Menjëherë

5. MZHETTS të bëjë transparente dhe publike vlerat reale të mbështetjes financiare së projekteve për turizmin, njëherësh duke specifikuar kriteret e sakta të përzgjedhjes së projekteve fituese, me pesha për secilin komponent duke bërë transparente formulën e përlogaritjes së peshave dhe pragun e lejuar.

Menjëherë dhe vijimësi

6. MZHETTS të marrë masa të menjëhershme, për të hartuar procedurën e monitorimit të projekteve, standartet e monitorimit, penaltetet për rastet e parregullsive dhe grupin e monitorimit duke vlerësuar 18 projektet e financuara në kuadër të mbështetjes financiare për projektet në turizëm dhe gjeneruar raporte auditimi financiare dhe narrative për justifikimin e zërave të buxhetit dhe aktiviteteve të programit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

A përdoret taksa e fjetjes në hotel për zhvillimin e turizmit?

- Nga NJQV mos vënia në dispozicion të grupit të auditimit të evidencave mbi investimet e të ardhurave nga taksa e fjetjes specifikisht në funksion të turizmit meqenëse paguhen nga turistët, ka sjellë përdorim për destinacione të tjera e këtij fondi të konsiderueshëm në funksion të objektivave të tjera të NJQV, të cilat nuk janë objekt i vjeljes së kësaj takse.

Për këtë rekomandojmë:

1. NJQV të marrin masa, në mënyrë të menjëhershme, për shfrytëzimin të të ardhurave nga taksa e fjetjes, në destinacion të turizmit dhe realizimit të objektivave lidhur me atë.

Menjëherë

A ekzistojnë risqe operacionale që vështirësojnë arritjen e objektivave në zhvillimin e turizmit?

- Mungesa e planeve të detajuara mbi organizimin e udhërrëfyesve në destinacionet turistike ka sjellë, mos informimin e turistit mbi shërbimet turistike dhe mungesën e metodave alternative të promovimit.

Për këtë rekomandojmë:

2. MZHETTS të hartojë dhe miratoj plane pune për organizimin në terren të udhërrëfyesit turistik.

Menjëherë dhe vazhdimisht

- Mungesa e auditimeve të brendshme për sektorin e turizmit dhe institucionet përgjegjëse për zhvillimin e tij, ka krijuar mangësira në përmbushjen me përpikmëri të detyrave funksionale që ngarkon Ligji 93/2015 “Për Turizmin”.

Për këtë rekomandojmë:

1. Drejtoria e Auditit të Brendshëm të kryejë auditime mbi strukturat përgjegjëse për turizmin, mbi realizimin e detyrave që ngarkohen sipas Ligjit 93/2015 “Për Turizmin”.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Për pyetjen: A ka mbivendosje të detyrave dhe përgjegjësive midis institucioneve të të gjitha niveleve?

- Në institucionet përgjegjëse të turizmit rezulton se ka mbivendosje të detyrave, konkretisht në promovimin e produktit, destinacionit turistik dhe investimeve në zonat me prioritet zhvillimin e turizmit brenda dhe jashtë shqipërisë, e cila sjell konfuzion në identifikimin e prioriteteve të institucioneve, si dhe pamundësinë e evidentimit të përgjegjësive.

Për këtë rekomandojmë:

1. AKB dhe DPZHT të përmirësojnë rregulloret dhe veprimtaritë e tyre përkatëse me fokus administrimin e zonave bregdetare dhe hartimin e politikave të qëndrueshme të turizmit, duke u përqendruar më pak në promovimin e produktit, destinacionit turistik dhe investimeve në zonat me prioritet zhvillimin e turizmit brenda dhe jashtë Shqipërisë. Në promovimin e turizmit shqiptar, si një detyrim tërësisht qendror i tyre, AKT dhe MZHETTS të shumëfishojnë përpjekjet në spektrin e strukturave, detyrave dhe kompetencave të fushës.

Menjëherë

Në mbështetje të nenit 15, germa “j” të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për masat e marra sipas programeve të përgatitura nga ana Juaj për zbatimin e rekomandimeve, të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit ***brenda 20 ditëve*** nga marrja e kësaj kërkesë, si dhe në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, të raportohet (*me shkrim*) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit ***brenda 6 muajve*** nga marrja e njoftimit të Raportit të auditimit, duke njoftuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R